



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com) | [info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)

038 500 878 | 044 500 878 | 049 500 878

Prishtinë, Ulpianë, rr. "Motrat Qiriaz" nr. 29

| PLANPROGRAMI MËSIMOR - SILLABUS                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                |                  |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                  |          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|----------|
| Niveli i studimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Bachelor                                                                                                       | Programi         | Menaxhment | Viti Akademik                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 2019-20                                                          |          |
| Lënda                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | ANGLISHTE EKONOMIKE I                                                                                          |                  |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                  |          |
| Viti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | I                                                                                                              | Statusi i lëndës | Obligative | ECTS/kredi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 6                                                                |          |
| Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | I                                                                                                              | 15               |            | Orët mësimore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Ligjërata                                                        | Ushtrime |
| Javët mësimore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                |                  |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 2                                                                | 1        |
| Metoda e mësimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Ligjërata interaktive, punë individuale, punë në çifte dhe punë grupe, prezantime të detyrave/projekteve, etj. |                  |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                  |          |
| Konsultime                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Njëherë në javë                                                                                                |                  |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                  |          |
| Mësimdhënësi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Dr.Sc.Agnesa Çanta                                                                                             |                  |            | Tel/mob                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 044/ 664-301                                                     |          |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                |                  |            | e-mail                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | <a href="mailto:cantaagnesa@gmail.com">cantaagnesa@gmail.com</a> |          |
| Asistenti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                |                  |            | Tel/mob                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                  |          |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                |                  |            | e-mail                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                  |          |
| Qëllimi studimor dhe përmbajtja e lëndës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                |                  |            | Përfitimet e studentit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                  |          |
| <p>Anglishte Ekonomike I është kurs semestral obligativ, i cili i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, që kanë të bëjnë me tema të ndryshme nga fusha e ekonomisë të ndërlidhura me përditshmërinë, nëpërmjet të cilave studentët do të jenë në gjendje të shprehin aftësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i përmirësojnë katër shkathësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, në funksion të rrjedhshmërisë dhe saktësisë. Temat e mbuluara gjatë kursit siç janë: brendet, kompanitë, marketingu, paraja, tregjet ndërkombëtare, lidershipi, etika, etj., do të përfshijnë një llojllojshmëri të ushtrimeve gramatikore dhe të leksikut të cilat do t'u ndihmojnë studentëve të arrijnë një zotërim të kënaqshëm të gjuhës angleze, duke pasur gjithmonë në fokus gërshtimin e kompetencës dhe performancës gjuhësore si imperativ për zotërimin e një gjuhe të huaj.</p> |                                                                                                                |                  |            | <p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të jenë në gjendje t'i kuptojnë qartë dhe pa vështirësi termat ekonomike nga temat e zhvilluara si dhe të komunikojnë pa vështirësi në lidhje me këto tema.</li> <li>2. Shkruajnë ese të cilat përmbajnë së paku 300 fjalë mbi temat e diskutura gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve;</li> <li>3. Zbatojnë njohuritë e tyre të gjuhës angleze në situata të ndryshme komunikuese me saktësi;</li> <li>4. Përdorin literaturë profesionale e cila ka të bëjë me fushën e tyre të studimeve dhe që korrespondon me nivelin e njohurive të fituara gjatë kursit;</li> <li>5. Krijojnë afinitet për gjuhën, gjë që padyshim do ta rriste interesimin e tyre për përmirësimin e mëtejshëm të njohurive të tyre të gjuhës angleze në fushën e ekonomisë.</li> </ol> |                                                                  |          |

## METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E TEMAVE MËSIMORE

Metodologjia e mësimdhënies bazohet kryekëput në Qasjen Komunikative, si ortodoksi dominante në botë në mësimdhënien e gjuhës angleze. Ligjëratat do të zhvillohen në formë interaktive duke i kyçur studentët në diskutime mbi tema të ndryshme të cilat mbulohen në këtë kurs, duke u dhënë udhëzime për përdorim të drejtë të gjuhës, si dhe duke organizuar një sërë aktivitete të cilat imitojnë përdorimin e gjuhës angleze jashtë klasës, siç janë: puna në çifte, puna në grupe, etj., në mënyrë që studentët të përgatiten që ta përdorin gjuhën, jo vetëm në klasë, por edhe jashtë saj. Diskutimet në kuadër të ushtrimeve do të zhvillohen në grupe të vogla në mënyrë që të nxitet karakteri garues i studentëve. Po ashtu, edhe prezantimet e projekteve dhe detyrave të tjera në kuadër të kursit do të jenë pjesë integrale e të mësuarit që do të ndikojnë në përmirësimin e shkathtësive gjuhësore të studentëve.

## KUSHTET PËR REALIZIMIN E TEMËS MËSIMORE

Librat, tabela, markerët, CD-të, DVD-të, laptopi, projektori.

Mënyra e vlerësimit të studentit (në %):

|                                                                                 | Vlerësimi në % | Nota përfundimtare |
|---------------------------------------------------------------------------------|----------------|--------------------|
| Performanca e studentëve në detyrat, projektet që i punojnë gjatë semestrit 10% | 91-100         | 10 (dhjetë)        |
| Performanca e tyre në kollokvium 20%                                            | 81-90          | 9 (nëntë)          |
| Angazhimi i tyre gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve 10%                           | 71-80          | 8 (tetë)           |
| Provim përfundimtar: 60%                                                        | 61-70          | 7 (shtatë)         |
|                                                                                 | 51-60          | 6 (gjashtë)        |

## OBLIGIMET E STUDENTIT

| Ligjëratat                                                                                                                                 | Ushtrime                                                                                                |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vijimi i ligjëratave,<br>Pjesëmarrja aktive,<br>Punime seminarike/projekte,<br>Pjesëmarrja në teste dhe ushtrime,<br>Provimi përfundimtar. | Pjesëmarrja në ushtrime,<br>Puna individuale dhe grupore në raste studimi,<br>Pjesëmarrja në diskutime. |

## NGARKESA E STUDENTIT PËR LËNDËN

| Aktiviteti                                                   | Orë | Ditë/Javë | Gjithsej |
|--------------------------------------------------------------|-----|-----------|----------|
| Ligjëratat                                                   | 2   | 15        | 30       |
| Ushtrime                                                     | 1   | 15        | 15       |
| Punë Praktike                                                | -   | -         | -        |
| Kontakte me mësimdhënësin                                    | 1   | 15        | 15       |
| Ushtrime në teren                                            | -   | -         | -        |
| Kollokfiume/seminare                                         | 2   | 1         | 2        |
| Detyra të shtëpisë                                           | 2   | 10        | 20       |
| Koha e studimit vetanak                                      | 2   | 15        | 30       |
| Përgatitja përfundimtare për provim                          | 2   | 15        | 30       |
| Koha e kaluar në vlerësime (teste, kuiz, provimi final)      | 3   | 1         | 3        |
| Projektet propozimet                                         | 5   | 1         | 5        |
| Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i |     | Ngarkesa  |          |

| ka 6 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë |                                                                                                                                          |      | totale:                                                                                                                      | 150  |
|-------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Java                                                                    | Ligjërata                                                                                                                                |      | Ushtrime                                                                                                                     |      |
|                                                                         | Tema                                                                                                                                     | Orët | Tema                                                                                                                         | Orët |
| 1                                                                       | Introduction. A brief introduction of the syllabus with emphasis on the topics to be discussed during the term.                          | 2    | Students introduce themselves by providing personal information and sharing their interests and goals with their colleagues. | 1    |
| 2                                                                       | Unit 1 Brands. Brand Management. Present Continuous and Present Simple. Restless pursuer of luxury's future - FT. Bulding luxury brands. | 2    | Case study. Hudson Corporation. Marketing Strategies for Europe - Options                                                    | 1    |
| 3                                                                       | Unit 2 Travel. British and American English. Counting the ways to bridge the gulf - FT. Talking about the future.                        | 2    | Case study. Business Travel Services. Socialising.                                                                           | 1    |
| 4                                                                       | Unit 3 Change. Describing change. Past Simple and Present Perfect. Mercedes star twinkles once more - FT. Briefing notes.                | 2    | Case study. Acquiring Asia Entertainment. Company profile.                                                                   | 1    |
| 5                                                                       | Unit 4 Organisation. Company structure. Noun combinations. Success can be a game with many players - FT.                                 | 2    | Case study. InStep's relocation.                                                                                             | 1    |
| 6                                                                       | Unit 5 Advertising. Advertising media and methods. Articles. A new kind of campaign - FT.                                                | 2    | Case study. Alpha Advertising. Panther Air. Safe Heaven. E-Book.                                                             | 1    |
| 7                                                                       | Unit 6 Money. Financial terms. Managing investments. Business in brief - FT. Dealing with figures.                                       | 2    | Case study. Make Your Pitch. International Meetings.                                                                         | 1    |
| 8                                                                       | Pre-test in Business English I                                                                                                           | 2    | Discussions about the pre-test                                                                                               | 1    |
| 9                                                                       | Unit 7 Cultures. Cultural differences. Idioms. Standard Bank overcomes culture shock - FT. Advice, obligation and necessity.             | 2    | Case study. Business culture briefing.                                                                                       | 1    |

|    |                                                                                                                      |   |                                                                     |   |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|---------------------------------------------------------------------|---|
| 10 | Unit 8 Human resources. Employing the right people. Women at work - FT. -ing forms and infinitives.                  | 2 | Case study. Fast Fitness. Job Applications                          | 1 |
| 11 | Unit 9 International markets. Free trade. Trade between China and the US - FT. Conditional Clauses.                  | 2 | Case study. Pampas Leather Company. Doing business internationally. | 1 |
| 12 | Unit 10 Ethics. Right or wrong. The ethics of resume writing - FT. Narrative tenses. Helping environmental research. | 2 | Case study. Principles or Profit? Agenda.                           | 1 |
| 13 | Unit 11 Leadership. Character adjectives. Father of the feel-good factory - FT. Relative clauses. Presenting.        | 2 | Case study. Lina Sports. Background & Problems & Strategy.          | 1 |
| 14 | Unit 12 Competition. Competition idioms. McDonald's stirs up battle with Starbucks - FT. Passives.                   | 2 | Case study. Fashion House. Communication Styles.                    | 1 |
| 15 | Review of Units 1-12                                                                                                 | 2 | Review of Units 1-12                                                | 1 |

### LITERATURA

Literatura bazë:

Cotton, D., & Fulvey, D., & Kent, S. (2016). *Market Leader Intermediate* (3<sup>rd</sup> Edition Extra). London: Pearson Longman & FT Publishing.

Literatura shtesë:

Murphy, R., & Smalzer, W. R. (2018). *Grammar in Use, Intermediate* (Fourth Edition). New York, NY: Cambridge University Press.

Cambridge Business English Dictionary. (2011). New York, NY: Cambridge University Press.  
Materiale të ndryshme nga Interneti.

### VËREJTJE

Për çdo njësi mësimore, përveç literaturës obligative që studentët duhet ta kenë me vete në ligjëratat dhe ushtrimet, me rastet, sipas nevojës, ata do të pajisen me materiale të tjera të nevojshme në gjuhën angleze, si dhe me udhëzime për kryerjen e detyrave. Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjëruar, e cila detyrë do të diskutohet dhe prezantohet nga studentët gjatë ushtrimeve.

### VËREJTJE PËR STUDENTIN

Studentët duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të respektojnë institucionin dhe rregullat akademike. Ata duhet t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet me rregull dhe të tregojnë interesim dhe angazhim të vazhdueshëm për lëndën, vullnet për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin dhe respekt për të gjithë personat që i rrethojnë. Ata duhet t'i ndjekin me përpikmëri udhëzimet e mësimit të tyre gjatë punimit të seminareve dhe detyrave të tjera në kuadër të studimeve dhe t'i dorëzojnë ato me kohë. Provimet vlerësohen individualisht për secilin student, prandaj ata duhet të përqëndrohen në njohuritë e tyre personale. Kopjimi është i ndaluar. Po ashtu, studentët janë të obliguar ta kenë me vete në provim indeksin ose ID-në e studentit, përndryshe nuk mund t'i nënshtrohen provimit. Shkelja eventuale e këtyre rregullave dhe në përgjithësi të gjitha rregullave të parapara sipas Statutit të Kolegjit "Biznesi" ndëshkohet konform normave ligjore.

**Profesori i lëndës:**

---

**Dr.Sc.Agnesa Çanta**